

RELACION

Mbi Ecurine Financiare Buxhetore të AMSHC-se për 3-mujorin e parë të vitit 2014

Agjencise per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile, në mbështetje të ligjit nr. Nr. 1185/2013, "Per buxhetin e shtetit për vitin 2014", Udhezimit te Ministrit te Financave nr. 2 datë 06.02.2012 "Per procedurat standarte te zbatimin te buxhetit" dhe Udhezimit nr.3 datë 17.01.2014 "Per zbatimin e buxhetin e shtetit për vitin 2014", i është akorduar një fond i planifikuar prej 120 milione e 500 mijë lekë, i cili përbehet nga:

Fondi i Pagave:	11,500,000 Lekë (zeri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqerore:	2,000,000 leke (zeri 601)
Fondi per Shpenzime Operative:	6,000,000 Lekë (zeri 602)
Fondi per transfertat ndaj te treteve:	100,000,000 Lekë (zeri 604)
Fondi per Investimet e Trupezuara:	1,000,000 Lekë (zeri 231)
TOTAL	120,500,000 LEKE

Nga fondi i pergjithshem buxhetor, per periudhen e raportuar, AMSHC, ka realizuar vlerën buxhetore në **9,564,008 leke** nga totali prej **120,500,000 Leke** ose **7.9 %** të fondit të planifikuar vjetor.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore (zeri 600-601), është realizuar në zbatim te strukturës organizative të miratuar, me VKM Nr. 769, date 15.07.2009 dhe te VKM Nr. 55 Date 26.01.2011 "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2011, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE".

Gjatë 3- mujorit të pare të vitit 2014, numri mesatar i punonjësve është realizuar 13 punonjes.

Nga fondi i pergjithshem i pagave dhe shperblimeve, si dhe i sigurimeve shoqerore, per këtë periudhë, është realizuar respektivisht;

2,582,721 Lekë (zeri 600) për paga, realizimi **22.4 %**.

407,290 Lekë (zeri 601) për kontribute për sigurimet shoqërore, realizimi **20 %**.

Fondi per shpenzime në zerin Mallra dhe Shërbime (zeri 602), per vitin 2014, është planifikuar ne vlerën 6,000,000 leke. Edhe për këtë zë, për periudhen respektive është realizuar vlera prej **305,997 Lekë** ose **0.5 %** e planit vjetor.

Gjithashtu, në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC është mbështetur në një shpërndarje sa më racionale të kërkesave, të cilat lidhen me;

- Realizimin e shpenzimeve, te detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, uje, shërbime postare e telefonike falas per publikun, ne funksion te nje veprimtarie normale institucionale.
- Kryerjen e te gjitha blerjeve per nevoja te AMSHC, publikime, blerje kancelarike, riparime automjeti, etj.
- Kryerjen e pagesave per likuidimin e detyrimeve furnitore dhe te trete, te mbartura nga 2013.

Fondi në zerin per Transferime Korrente te Brendshme (zeri 604), per vitin 2014 është planifikuar ne vlerën 100,000,000 leke. Ky eshte dhe zeri me me peshe ne strukturen e buxhetit te AMSHC, duke qene se dhe vete misioni i ketij institucioni ka si qellim kryesor financimin e Shoqerise Civile me Grante per projektpropozimet te OJF perfituese.

Edhe për këtë zë, për periudhen respektive është realizuar vlera prej **6,268,000 Lekë** ose **6.2 %** e planit vjetor.

Në realizimin e ketij zeri, AMSHC ka vazhduar me disbursimet per këstin e dyte dhe te trete persa i perket Thirrjes Nr.3 si dhe ndjekjen dhe disbursimet per kontraktimet e Thirrjes Nr.4

Fondi per shpenzim investime (zeri 231) ,

1,000,000 Lekë (zeri 231) për Investime te Trupezuara, realizimi **0%**.

AMSHC, ka zbatuar me korrektesi te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga Ligji Nr. 10093 Date 09.03.2009 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Agjencise per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile", si dhe legjislacionin admnistrativo-financiar shqiptar.

Drejtor Ekzekutiv

RUDI BOBRATI